

VENDIM
Nr. 733, datë 27.11.2024

PËR MIRATIMIN E SKEMËS MBËSHTETËSE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVIT KOMBËTAR PËR BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË NË SEKTORIN E NGROHJES DHE FTOHJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të masave mbështetëse për arritjen e objektivit kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë në sektorin e ngrohjes e të ftohjes.

2. Institucioni përgjegjës për realizimin e skemës mbështetëse është agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë.

3. Burimet e financimit për skemën e mbështetjes përfshijnë:

a) të ardhura nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore; ose

b) të ardhurat e institucionit përgjegjës për realizimin e skemës mbështetëse;

c) burime të tjera financimi jashtë buxhetit të shtetit, përfshirë burimet e financimeve të huaja, nëpërmjet programeve apo projekteve të ndryshme për promovimin e eficiencës, burimeve të rinovueshme dhe kursimit të energjisë.

4. Kontributi i energjisë së rinovueshme në kërkesën finale për energji dhe mënyra e mbështetjes për sektorin e ngrohjes dhe ftohjes për arritjen e objektivave përcaktohen në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

5. Termat e përcaktuar në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) **“Klient familjar”**, një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale dhe është i lidhur me tensionin deri 400 V;

b) **“Sistemet diellore të ngrohjes së ujit”**, sistemet e përbëra nga kolektorë diellorë me sipërfaqe nga 1 m² deri në 6 m² dhe me një depozitë për grumbullimin e ujit të ngrohtë nga 100 në 300 litra, që funksionojnë sipas metodës termosifon;

c) **“Metoda termosifon”**, një metodë për shkëmbimin pasiv të nxehtësisë, bazuar në konveksion natyral që qarkullon fluidin pa nevojën e një pompe ose sistemi mekanik pompimi;

ç) **“Kaldaja”**, një pajisje e cila shfrytëzon nxehtësinë nga djegia e një lënde djegëse për ngrohjen në temperaturë të ulët, të mesme ose të lartë të një fluidi që më pas e transmeton këtë energji për një përdorim të dobishëm;

d) **“Pompë nxehtësie”**, një pajisje që duke përdorur energji mekanike transferon nxehtësinë nga një zonë me temperaturë më të ulët në një zonë me temperaturë më të lartë.

II. SKEMA MBËSHTETËSE, ASPEKTET FINANCIARE DHE TEKNOLOGJITË QË PROMOVOHEN

II.1. MASAT SPECIFIKE PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE

1. Mbështetja financiare jepet në formën e mbështetjes në investim.

2. Mbështetja në investim do të mbulojë në çdo rast vetëm një pjesë të kostos së nevojshme për blerjen dhe instalimin e teknologjive që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie, për realizimin e ngrohjes dhe ftohjes.

3. Forma e masës mbështetëse përcaktohet në ndarjen II.2, të këtij kreu II, në varësi të teknologjisë që shfrytëzon burime të rinovueshme energjie.

4. Mënyra e përfitimit të masës mbështetëse përcaktohet, bazuar në formën e saj dhe burimit të financimit, në urdhrin e ministrit sipas pikës 1, të ndarjes II.3, të këtij kreu.

5. Vlera dhe lloji i masës mbështetëse përcaktuar në këtë vendim ndryshohen periodikisht, të paktën çdo dy vjet, në varësi të një analize të detajuar të bazuar mbi kosto-përfitimin dhe zbatueshmërinë për çdo teknologji përkatëse.

6. Çdo masë mbështetëse, që përbën ndihmë shtetërore, i nënshtrohet miratimit sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën shtetërore.

II.2. TEKNOLOGJITË E RINOVUESHME NË NGROHJE DHE NË FTOHJE, KËRKESAT MINIMALE DHE FINANCIMI

1. Klientët familjarë mund të aplikojnë për përfitimin e skemës mbështetëse sipas njërës prej teknologjive të paraqitura në pikën 3 të kësaj ndarjeje.

2. Aplikimi i skemës mbështetëse nis pas miratimit të urdhrit sipas pikës 1, të ndarjes II.3, të këtij kreu.

3. Kërkesat minimale dhe financimi i teknologjisë përkatëse që shfrytëzon burime të rinovueshme energjie janë, si më poshtë vijon:

a) Për sistemet diellore të ngrohjes së ujit:

i. financimi përfshin 70% të vlerës së investimit, llogaritur për një vlerë maksimale investimi prej 140 000 (njëqind e dyzet mijë) lekësh, pa TVSH;

ii. sipërfaqja e kolektorëve deri në 6 m²;

iii. kapaciteti i depozitës deri në 300 litra;

iv. efienca e sistemit mbi 50%.

b) Për kaldajat me biomasë ose biokarburant:

i. financimi përfshin 20% të vlerës së investimit për një vlerë maksimale investimi prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, pa TVSH;

ii. fuqia nominale deri në 16 kw;

iii. konsumi i lëndës djegëse deri në 5 kg/orë;

iv. efienca e kaldajës mbi 85%.

c) Për pompat e nxehtësisë (ajër, ujë, gjeotermale):

i. financimi përfshin 20% të vlerës së investimit për një vlerë maksimale investimi prej 600 000 (gjashtëqind mijë) lekësh, pa TVSH;

ii. fuqia nominale deri në 20 kw;

iii. koeficienti i performancës mbi 4.5;

ç) Për ngrohjen dhe ftohjen qendrore në banesa:

i. financimi përfshin 30% të vlerës së investimit për një vlerë maksimale investimi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, pa TVSH;

ii. fuqia nominale mbi 250 kw;

iii. koeficienti i performancës mbi 2.

II.3. SKEMA MBËSHTETËSE

1. Ministri miraton urdhrin për përcaktimin e kuotave, kritereve, rregullave, procedurave dhe metodologjisë për klientët familjarë që përfitojnë nga masat e financimit për kursimin e energjisë nga:

a) panelet diellore për ngrohjen e ujit me depozitë;

b) impiantet e vogla të biomasës;

c) pompat e nxehtësisë;

ç) ngrohja dhe ftohja qendrore.

2. Urdhri, sipas pikës 1 përcakton të gjitha kriteret e nevojshme për realizimin me sukses dhe shfrytëzimin afatgjatë të teknologjisë së përfutur përmes skemës mbështetëse, duke përfshirë kriteret e projektimit, të sigurisë, të qëndrueshmërisë, të mirëmbajtjes periodike dhe strukturën monitoruese.

3. Përfitimi i mbështetjes sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1, të kësaj ndarjeje, do të mundësohet vetëm për rastet kur klientët fundorë synojnë të zëvendësojnë teknologji ekzistuese

që shfrytëzojnë burime fosile. Urdhri i ministrit ezauron në mënyrë specifike të gjitha kërkesat dhe kriteret përkatëse të teknologjive.

4. Përpara përfitimit të mbështetjes sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, klientët fundorë duhet të garantojnë të paktën plotësimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa, sipas vendimit nr. 537, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, përmes certifikatës përfundimtare të performancës së energjisë.

5. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë propozon skemat, të cilat përfshijnë kriteret, rregullat, procedurat dhe metodologjinë e përfitimit nga klientët familjarë të masave të financimit për kursimin e energjisë në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes.

III. APLIKIMI DHE KUALIFIKIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

III.1. PROCEDURA E REGJISTRIMIT PËR OPERATORËT EKONOMIKË

1. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë shpall hapjen e aplikimeve për regjistrimin e operatorëve ekonomikë që tregtojnë ose instalojnë teknologjitë e rinovueshme në ngrohje dhe në ftohje, me qëllim evidentimin e teknologjisë dhe ofertën për instalimin e saj.

2. Pajisjet e ofruara duhet t'i përkasin dy klasave më të larta të eficiencës së energjisë, në përputhje me ligjin për etiketimin e produkteve me ndikim në energji dhe akteve nënligjore përkatëse.

3. Operatorët ekonomikë dërgojnë ofertat ekonomike për modelet e pajisjeve që ato tregtojnë, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe në urdhrin e ministrit sipas pikës 1, të ndarjes II.3, të kreut II, së bashku me listën e dokumenteve të kërkuara sipas ndarjes III.3 të këtij kreu.

4. Procesi i regjistrimit të operatorëve ekonomikë dhe kualifikimi i tyre realizohen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike.

III.2. KUSHTET DHE KRITERET PËR REGJISTRIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË

Operatorët ekonomikë që duan të jenë pjesë e ofruesve të kësaj skeme duhet plotësojnë këto kriteret:

- a) të jenë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas legjislacionit në fuqi, të kenë status aktiv dhe të kenë në fushën e veprimtarisë objektin e financimit;
- b) të vërtetojnë se nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore;
- c) të sigurojnë dokumente që vërtetojnë se garancia e pajisjes është në përputhje ose më e madhe sesa koha e përcaktuar në urdhrin e ministrit sipas pikës 1, të ndarjes II.3, të kreut II;
- ç) të disponojnë skedën teknike të instalimit termik, sipas kriterëve teknike të kërkuara;
- d) të disponojnë preventivin/ofertën për instalimin termik, duke përfshirë dhe kostot e transportit e të instalimit. Oferta financiare do të jetë detyruese dhe ofertuesi nuk mund të lëshojë faturë me çmim të ndryshëm nga oferta e paraqitur për çdo aplikues, në varësi të qytetit;
- dh) të deklarojnë një listë statistikore të qyteteve ku mund të ofrojnë shërbimin;
- e) të disponojnë një deklaratë përgjegjësie për çdo kontratë shitjeje, sipas së cilës pranojnë kryerjen e shërbimit kundrejt konsumatorëve familjarë nga shitja deri te kolaudimi i sistemit termik, brenda afatit të përcaktuar në urdhrin sipas pikës 1, të ndarjes II.3, të kreut II.

III.3. LISTA E KËRKUAR E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR APLIKIM

1. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë operatori për aplikim është si më poshtë vijon:

- a) kërkesa për regjistrim si operator, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor, e cila përmban të dhënat e subjektit, NIPT-in dhe adresën;
- b) vërtetimi mbi garancinë e sistemit;
- c) skeda teknike për komponentët kryesorë të sistemit.

2. Kriteret e përcaktuara në shkronjat “dh” dhe “e” të ndarjes III.3, të këtij kreu, plotësohen përmes dorëzimit të një vetëdeklarimi.

IV. KLIENTËT FAMILJARË PËRFITUES, APLIKIMI DHE PËRZGJEDHJA

IV.1. PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë shpall datën e nisjes së aplikimeve me kërkesë për klientët familjarë pas përfundimit të procesit të regjistrimit të operatorëve ekonomikë.

2. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për pranimin e kërkesave, publikon të gjitha dhënat e subjekteve të kualifikuara së bashku me listën e produkteve që ato ofrojnë, si dhe vlerat ekonomike për çdo produkt në platformën *online*, të ndërtuar për këtë qëllim.

3. Procesi i dorëzimit të kërkesave nis në orën 00:01 të datës së caktuar.

4. Me dorëzimin e kërkesës, kërkuesi pajiset me një numër rendor dhe merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve pune për pranimin ose jo të aplikimit të tyre.

5. Vlerësimi i kërkesave bëhet sipas numrit rendor.

6. Subjektet, që nuk kualifikohen, njoftohen për arsyet e mospranimit të aplikimit dhe kanë të drejtë të çelin një aplikim të ri, duke humbur numrin rendor të mëparshëm.

7. Çdo kërkesë e dorëzuar pas plotësimit të kuotave fituese nuk do të konsiderohet.

IV.2. KUSHTET DHE KRITERET PËR KLIENTËT FAMILJARË PËRFITUES

1. Klientët familjarë, që kërkojnë të aplikojnë për përfitimin e mbështetjes për realizimin e investimit, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të paraqesin një vërtetim ose kontratën ekzistuese me OSHEE/FSHU-në ku të jenë të klasifikuar si abonentë familjarë ose një historik të konsumit të energjisë prej të paktën 1 viti, vërtetuar me vërtetim nga furnizuesi ose me fatura;

b) të paraqesin dokumente ku të vërtetohet se konsumi mesatar i energjisë elektrike për vitin paraardhës duhet të jetë më i madh se 400 kwh për çdo muaj, kur aplikohet për sistemet që shfrytëzojnë burime të rinovueshme sipas shkronjës “a” të pikës 3, të ndarjes II.2, të kreut II;

c) të paraqesin raportin e auditimit energjetik, sipas ligjit për eficiencën e energjisë, kur aplikohet për sistemet që shfrytëzojnë burime të rinovueshme, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të ndarjes II.2, të kreut II;

ç) të paraqesin dokumente ku të vërtetohet se nuk janë debitorë ndaj OSHEE-së/FSHU-së;

d) të paraqesin dokumente ku të vërtetohet se kanë paguar të gjitha taksat vendore.

dh) të zotërojnë certifikatë pronësie për banesën ose njësinë e banimit (rastet që janë në proces legalizimi nuk do të konsiderohen).

2. Kriteri i përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 1, nuk do të zbatohet për abonentët që klasifikohen si konsumatorë që trajtohen me ndihmë ekonomike nga ministria përgjegjëse për punët sociale.

3. Konsumatorët familjarë, të cilët do të kualifikohen për përfitimin nga kjo skemë mbështetëse, do të duhet të përzgjedhin një nga subjektet e regjistruara pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë për marrjen e shërbimit.

4. Kriteria të tjera specifike për klientët familjarë përfitues do të përcaktohen në urdhrin përkatës sipas pikës 1, të ndarjes II.3, të kreut II.

IV.3. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Lista e dokumenteve që duhet të paraqitet për aplikim është, si më poshtë vijon:

a) letërnjoftimi (karta e identitetit);

b) certifikata familjare;

c) certifikatë pronësie;

ç) faturat e OSHEE-së/FSHU-së ose vërtetim faturash për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit;

d) vërtetim të ardhurash për çdo pjesëtar të familjes;

dh) vërtetim që abonenti nuk rezulton debitor ndaj OSHEE-së/FSHU-së;

e) për konsumatorët në nevojë, një vërtetim nga ministria përgjegjëse për punët sociale që abonenti bën pjesë në këtë kategori;

ë) projekti dhe relacioni i realizuar nga një inxhinier i licencuar të paktën sipas kategorisë 4.b, të vendimit nr. 759/2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të ndryshuar, shoqëruar me deklaratën e përgjegjësisë profesionale dhe licencën përkatëse. Ky dokument mund të përjashtohet vetëm për impiantet diellore për ngrohjen e ujit;

f) Sipas rastit, leje për realizimin e punimeve referuar parashikimeve të vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar;

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Zbatimi i skemës mbështetëse monitorohet nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë në bashkëpunim me struktura të tjera, të cilat përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë për ngritjen e grupit të monitorimit.

2. Grupi për monitorimin e procesit ngrihet menjëherë pas miratimit të urdhrit sipas pikës 2, të ndarjes II.3, të kreut II, dhe përbëhet nga 5 anëtarë me formim, si më poshtë vijon:

a) 3 (tre) inxhinierë mekanikë/mjedisi/drejtimi energjetik; ose

b) 2 (dy) ekonomistë/juristë.

3. Grupi për monitorimin dhe verifikimin e skemës mbështetëse ndjek të gjitha procedurat në terren për mbikëqyrjen e procesit dhe raporton në mënyrë periodike tek agjencia përgjegjëse për eficiencën energjisë dhe çdo 6 (gjashtë) muaj pranë ministrit përgjegjës për energjinë.

4. Të gjitha kursimet e arritura raportohen si pjesë e masave të marra në kuadër të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

5. Institucionet publike dhe subjektet private, të cilat mund të klasifikohen si klientë, nuk përfitojnë nga skema mbështetëse sipas këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku